



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:103376

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06077889

C.nr.197/22

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve F.Z.H.KE.Rdhe S.S.të punësuar në SHFMU “Ismet Jashari- Kumanova” në fshatin T., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër të licencimit/kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 22.08.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.Z.H.KE.Rdhe S.S.të punësuar në SHFMU “Ismet Jashari- Kumanova” në fshatin T., Komuna e Malishevës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që në emër të kompensimit të kualifikimit/licencimit, t`ua paguaj paditësve si në vijim:

- Paditësit **F.Z.**dhe atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € * 27% i pagës bazë (113.67€ - 46.66 diferencë e paguar në page = 67.01 €) për periudhën e vitit 2019 dhe 2020 x 24 muaj gjithsej 24* 67.01 = **1,608.24 euro**;
- Paditësit **H.K.**dhe atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € * 27% i pagës bazë (113.67€ - 58.32 diferencë e paguar në page = 55.35 €) për periudhën e vitit 2019 dhe 2020 x 24 muaj gjithsej 24* 55.35 = **1,328.40 euro**;
- Paditësit **S.S.**dhe atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € * 19% i pagës bazë (79.99€ - 58.32 diferencë e paguar në page = 21.67 €) për periudhën e vitit 2019 dhe 2020 x 24 muaj gjithsej 24* 21.67 = **520.08 euro**;

- Padiësit **E.R.** dhe atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € * 27% i pagës bazë (113.67€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 55.35 €) për periudhën e vitit 2019 dhe 2020 x 24 muaj gjithsej 24* 55.35 = **1,328.40 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 13.04.2022, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkespadiës e padiësve kërkuar në emër të kualifikimit për 8 muaj për vitin 2017 dhe për 12 muaj për vitin 2018,

IV. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkespadiës e padiësit S.S.e kërkuar mbi pagën bazë prej 19 % në emër të kualifikimit/licencimit.

V. DETYROHET e paditura që padiësve pjesërisht t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 624.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të padiësit në emër precizimit të padisë shumën prej 624.00 euro dhe shumën prej 811.20 euro në emër të seancave.

A r s y e t i m

Padiësit A.K.G.K.N.H.S.Htë punësuar në SHFMU "I.M" në Malishevë përmes të autorizuarit të tyre Av. Zahir Hamza nga Prishtina në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë padiësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU "I.M" në Malishevë, padiësit e sipërshtënuar i plotësojnë kushtet e përfitimit mbi bazën e kualifikimit sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendojmë se u takon kompensimi, gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadija e padiësve.

I autorizuari i padiësve përmes parashtrësës ka bërë precizimin e padisë, ashtu që për padiësin F.Z. sipas kontratës kolektive për titullin me diplomë i takon 27 % të pagës bazë, sipas vlerës së gradimit 113.67 euro apo (421 euro x27%) =113.67, zbritja e pjesëshme 46.66 euro apo 113.-58.32=46.66 mbetje për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020 për vitin 2017 -8 muaj në shumën prej 536.08 euro, për vitin 2018-12 muaj në shumën prej 804.12 euro, për vitin 2019-12 muaj në shumën prej 804.12 euro, për vitin 2020-12 muaj, në shumën prej 804.12 euro, gjithsejtë 2,948.44 euro, për padiësin H.K.sipas kontratës kolektive për titullin me diplomë i takon 27 % të pagës bazë, sipas vlerës së gradimit 113.67 euro apo (421 euro x27%) =113.67, zbritja e pjesëshme 58.32 euro apo 113.-58.32=55.35 mbetje për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020 për vitin 2017 -8 muaj në shumën prej 442.80 euro, për vitin 2018-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2019-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2020-12 muaj, në shumën prej 664.20 euro, gjithsejtë 2,435.40.00 euro, për padiësin E.R. sipas kontratës kolektive për titullin me diplomë i takon 27 % të pagës bazë, sipas vlerës së gradimit 113.67 euro apo (421 euro x27%) =113.67, zbritja e pjesëshme 58.32

euro apo $113.-58.32=55.35$ mbetje për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020 për vitin 2017 -8 muaj në shumën prej 442.80 euro, për vitin 2018-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2019-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2020-12 muaj, në shumën prej 664.20 euro, gjithsejtë 2,435.40.00 euro, për paditësin S.S. sipas kontratës kolektive për titullin me diplomë i takon 27 % të pagës bazë, sipas vlerës së gradimit 113.67 euro apo $(421 \text{ euro} \times 27\%) = 113.67$, zbritja e pjesëshme 58.32 euro apo $113.-58.32=55.35$ mbetje për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 31.12.2020 për vitin 2017 -8 muaj në shumën prej 442.80 euro, për vitin 2018-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2019-12 muaj në shumën prej 664.20 euro, për vitin 2020-12 muaj, në shumën prej 664.20 euro, gjithsejtë 2,435.40.00 euro, gjithsejtë 2,435.40.00 euro, të gjitha me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t'ia paguaj shumën prej 624.00 euro, në emër të taksës shumën prej 20 euro, në emër precizimit të padisë shumën prej 624.00 euro dhe shumën prej 811.20 euro në emër të seancave.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi në këtë rast e lidhur me pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive, për faktin se baze të kontratës së mësimdhënësve kualifikimi i paguhet çdo mësimdhënësi që është paraqitur në kontratën e punës gradimi mbi pagën bazë. Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, në veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësit pretendon se i takon e drejta e kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, kjo dispozitë përcakton se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karriere dhe zhvillim profesional në baze të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplome fakulteti tri dhe katër vjeçare 27⁰/0 të pagës bazë, padia është në tërësi e pabazuar dispozitat e këtij neni nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit, por kjo dispozitë se lartcekur shihet qarte që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe assesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate [RREGULLAT E PERGJITHSHME DHE PAGAT], ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të të paditurës: kompensimi për orët shtese, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të kontratës, për çka pretendimet e paditësve për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se "Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHKut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në

Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.", andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara. Po ashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës kolektive të arsimit vitit 2017, kemi të bëjmë me parashkrim në bazë të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së .Kjo kërkesë padi është e pasafatshme pasi që është paraqitur më dt: 02.08.2021, katër, vite më vonë pasi kontrata kolektive e vitit 2017 ka skaduar më dt: 18.04.2020, pra kjo kontratë ka qen tri vite në fuqi në bazë të dispozitave të ligjit të punës i Propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë, të Refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve sepse, nuk ekziston asnjë bazë ligjore lidhur me këtë raste që ekziston ky detyrim në bazë të kontratës kolektive të vitit 2017.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin S.S., vërtetimin nr.115/2022 të datës 31.03.2022, Diplomën nr. 1118 e datës 02.12.2008, Kontratën e Punës nr.11/447 të datës 09.11.2021, Licencën e Mësimdhënësit nr.100007611, për paditësin E.R.vërtetimin nr.115/2022 të datës 31.03.2022, Licencën e Mësimdhënësit nr.100007610, H.K.vërtetimin nr.115/2022 të datës 31.03.2022, Diplomën nr.150 e datës 01.01.2013, kontratën e punës nr.11/350 të datës 26.10.2015, për paditësin F.Z.vërtetimin nr.115/2022 të datës 31.03.2022 Licencën e Mësimdhënësit nr.100022397, Diplomën nr.456 e datës 01.08.2011, Kontratën e Punës nr.11/840 të datës 14.10.2015 dhe listën e pagës për të gjithë paditësit.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar, ndërsa e aprovojë pjesërisht për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU "I.M" në Malishevë, ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompenzimin e plotë në emër të licencimit/kualifikimit, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 7 paragrafi 1, pika 3 në të cilën përcaktohet se ***"Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë"***.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 në pikën 4 përcaktohet se ***"Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%, me diplomë, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej***

19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%” ndërsa nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të nxjerrë nga seanca e përgjithshme i datës 09.10.2023 GJ.A-SU 214/2023 i cili derivon nga vendimi i Qeverisë së Kosovës në pikën I përcaktohet se **“Për kërkesat e mësimeve për kompensimin mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushtëve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008,”** kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e Kontratës Kolektive- Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës paditëseve i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, poashtu sa i përket të drejtës në kompensimin e mjetëve në emër të licencimit/kualifikimit, gjykata u bazua në diplomat e kualifikimit të paditësve, licencimin dhe kontratën e punës.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që të përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e fillë Kolektive”**.

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit të shujtave . Andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësve.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e të tilla i konsideroi pjesërisht të bazuara, përkatësisht gjykata vlerëson se kërkesa e paditësve për periudhën për vitin 2017 dhe periudhën e vitit 2018

është e parashkruar, ngase në vështrim të shkresave të lëndës, konstatohet se paditësit padinë e kanë parashtruar në vitin 2021, ndërsa kërkesa e padisë rezulton e kërkuar nga viti 2017 ndërsa sa i përket kërkesave pas vitit 2018 për gjykatën padia rezulton e afatshme e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit S.S.të kërkuara mbi pagën bazë prej 19 % në emër të kualifikimit/licencimit, pasi që nga shkresat e lëndës përkatësisht nga shikimi i diplomave të kualifikimit u vërtetua fakti se i njëjti ka përgatitje të Shkollës së Lartë Pedagogjike, , andaj nisur nga një gjendje e tillë faktike dhe duke interpretuar të njëjtën me normën juridike të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ku në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, pika 3 në të cilën përcaktohet se **“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë**, andaj mbi bazën e këtyre faktëve gjykata vendosi që shumat e kërkuara përtej shkallës prej 19% ti refuzoj si pa bazuara.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë (13.04.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”* dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë shumën prej 624.00 euro në emër të parashtrimit të padisë dhe shumën prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa e refuzoi shumën prej 624.00 euro të kërkuar në emër të shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadisë dhe shumën prej 811.20 euro në emër të seancave, për shkakun e marrjes së aktgjykimit jashtë shqyrtimit gjyqësor, sipas dispozitës së lartëcekur mbi shpenzimet procedurale.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.197/21 me datën 22.08.2024

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.